



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**

**PROGRAMET E KULTURËS SË PËRGJITHSHME TË ARSIMIT
PROFESIONAL – TEKNIK (APT)**

PROGRAMI I LËNDËS

**Anglisht
Klasa e 11-të**

STRUKTURA e APT: 2+1+1 vite, 2 + 2 vite, bllok 4-vite

DREJTIMI i APT: Të gjitha drejtimet e arsimit profesional-teknik

Koordinatori: ERIFILI HASHORVA

Redaktori: GAZMEND KRASNIQI

Përgjegjës sektori: MARITA HAMZA

TIRANË, KORRIK 2010

Programi i gjuhës angleze për klasën e 11-të është një dokument zyrtar dhe ka për qëllim të arrijë dhe të realizojë standardet e mësimdhënies, të mësim-nxënies dhe të vlerësimit të nxënësit, në nivelin gjuhësor B1.2, sipas Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët (KPER), duke mundësuar që nxënësi nga përdorues i nivelit prag B1+ të gjuhës në klasën e 10-të të bëhet përdorues prag i pavarur në përfundimin e studimeve në klasën e 11-të.

Programi i klasës së 11-të për gjuhën angleze për kulturën e përgjithshme në arsimin profesional, për drejtimin: mekanik, elektronik, elektronik, hoteleri-turizëm, teknologji ushqimore, përpunim druri, bujqësi, peshkim, termohidraulik, ndërtim, etj. ka për synim njohjen e mëtejshme të gjuhës dhe kulturës së vendeve anglishtfolëse, në mënyrë që nxënësit të përgatiten mundësisht për studime të mëtejshme, si dhe për tregun e punës brenda dhe jashtë vendit.

Programi i klasës së 11-të për gjuhën angleze, siguron ndërthurjen e njohurive të përfuara gjatë këtij programi me dijet e marra në lëndët e tjera, p.sh.: histori, gjeografi, biologji etj. Kjo lidhje ndërlëndore i shërben formimit të përgjithshëm kulturor të nxënësve, si pjesë e pandarë e arsimimit të tyre profesional.

Programi i klasës së 11-të për gjuhën angleze siguron zhvillimin e personalitetit të nxënës/it,-es jo vetëm nëpërmjet gjuhës dhe kulturës angleze, por edhe nëpërmjet marrjes së përgjegjësisë në procesin e të nxënësve në gjuhën e huaj.

1. SYNIMI I LËNDËS

Programi i klasës së 11-të për gjuhën angleze synon:

- të thellojë njohuritë dhe shprehjet gjuhësore duke zhvilluar të katër shprehjet, përkatësisht të dëgjuarit, të lexuarit, të folurit e të shkruarit, në mënyrë që nxënësi të mund të arrijë nivelin B1+ në përfundim të programit;
- të ndërgjegjësojë nxënësit për kulturën e vendeve anglishtfolëse;
- të aftësojë nxënësit të reagojnë ndaj dallimeve ndërmjet kulturave të dy gjuhëve;
- të trajtohen dhe të mësohen njohuritë gjuhësore e kulturore dhe teknike duke i bërë ato lehtësisht të përdorshme në kontekste të caktuara kuptimore dhe praktike të jetës së përditshme.
- të zhvillojë komunikimin gjuhësor e ndërkulturor të nxënësve në përputhje me nivelin dhe moshën e tyre.

2. OBJEKTIVA TË PËRGJITHSHËM

Objektivat e përgjithshëm përcaktohen e detajohen sipas katër aftësive gjuhësore, fushave tematike dhe funksioneve gjuhësore. Ata janë të rëndësishëm për organizimin e procesit mësimor dhe vlerësohen nga mësuesi e vetë nxënësit. Për më tepër, parashtrimi i objektivave mundëson pavarësinë e nxënësve në procesin e nxënies.

Programi i klasës së 11-të i gjuhës angleze për shkollat profesionale synon të pasqyrojë dhe të ndërthurë njohuritë e gjuhës angleze me lëndët e tjera, duke zhvilluar tek nxënësi:

Signat

- shkathhtësinë me shkrim dhe me gojë;
- saktësinë me shkrim dhe me gojë;
- aftësinë për të lidhur situatat gjuhësore të krijuara në klasë me ato të jetës reale;
- aftësinë për të bërë dallimet ndërmjet kulturave të ndryshme.

Njohuritë e përshkruara në objektiva janë të detyruara për përdoruesit e programit dhe për të gjithë nxënësit.

3. OBJEKTIVA

a) Objektiva sipas standardit në komunikim

Përshkrimi. Objektivat e standardeve në këtë fushë theksojnë thellimin e njohurive drejt nivelit gjuhësor B1.2, duke mundësuar që nxënësi nga përdorues i nivelit prag B1+ të gjuhës në klasën e 10-të të bëhet përdorues prag i pavarur, sipas tabelës së vlerësimit në Kuadrin e Përgjithshëm Evropian për Gjuhët. Në këtë mënyrë nxënës/it,-et bëhen të aftë të thellojnë ndërveprimin gjuhësor, për të realizuar më mirë komunikimin në gjuhën angleze. Në nivelin B1+ sigurohet një pjesëmarrje më aktive në komunikim, duke përballuar situata më të ndërlikuara me një sasi informacioni dhe shkalle informacioni më të lartë.

	Objektiva
Komunikimi	<p>Në fund të klasës së 11-të nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të ndjekë pa vështirësi biseda me shpejtësi normale; • të kuptojë, të këmbëjë; të miratojë; të kundërshtojë; informacione të fushës së tij të interesit; • të përcjellë një informacion të kërkuar; • të shprehë pëlqimet e mospëlqimet; • të krahasojë; • të shprehë ndërvarjen e veprimeve, e fakteve etj.; • të përsërisë; • të ndërveprojë; • të identifikojë mesazhin; • të shkruajë; • të hartojë; • të përshkruajë; • të përmbledhë mendimet dhe të nxjerrë përfundime; • të bëjë kërkime dhe të analizojë <p>në situata të ndryshme, si p.sh.: jeta e përditshme në shkollë dhe jashtë saj, bota rreth nesh, bota e komunikimit, fusha e tij profesionale, etj.</p>

Veprimtaritë e komunikimit	<p>Në fund të klasës së 11-të nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të miratojë dhe të korrigjojë; • të kundërshtojë; • të formulojë një ankesë; • të kërkojë e të japë leje; • të urojë; • të shprehë keqardhje dhe dëshira; • të falë dhe të kërkojë falje; • të nxisë; • të shprehë pëlqime dhe mospëlqime; • të verifikojë <p>për përvoja të ndryshme në situata të jetës së përditshme, si: festa, mbrëmje, takime, ditëlindje, udhëtime, shërbime të ndryshme të fushës së tij, etj.</p>
-----------------------------------	---

b) Objektiva sipas standardit në kulturë

Përshkrimi: Duke u mbështetur në njohuritë e mëparshme, nxënës/i,-ja i/e klasës së 11-të zgjeron dhe thellon më tej njohuritë për elementë të ndryshëm të kulturës së vendeve anglishtfolëse, duke bërë krahasime dhe vendosur marrëdhënie me kulturën e gjuhës amtare.

	Objektiva
Kultura	<p>Në fund të klasës së 11-të nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të vendosë marrëdhënie ndërmjet kulturës amtare dhe kulturës së huaj; • të zotërojë njohuri të karakterit të përgjithshëm për të dhënat gjeografike, ekonomike e politike si dhe të karakterit profesional të vendeve anglishtfolëse; • të përdorë sipas regjistrave të ndryshëm të gjuhës (zyrtare, miqësore, konfidenciale, normale, informale etj.) rregullat e mirësjelljes të popullit, gjuhën e të cilit mëson, (përdorim i urimeve, përshëndetjeve, formave të adresimit, fjalëve të urta etj.); • të kërkojë fjalën në publik, duke përdorur gjeste, dhe duke mbajtur pozicion të përshtatshëm për ligjërimin; • të shmangë format urdhërore, duke i zbutur ato me kushtoren kur shpreh një kërkesë; të dijë si të përdorë pasthirrat etj.; <p>të komentojë mbi zhvillimet më të</p>

Signatura

	rëndësishme në fushat përkatëse profesionale si dhe rolin e personaliteteve më të rëndësishëm.
--	--

c) Objektivat sipas standardit në formimin gjuhësor

Përshkrimi. Objektivat e standardit në këtë fushë e aftësojnë nxënës/in,-en të përdorë elementë gjuhësore në një shkallë vështirësie që i përket nivelit B1.2. Strukturat gjuhësore në këtë nivel realizohen nëpërmjet situatave të ndryshme ligjërimore, ku nxënës/i,-ja nxitet të praktikojë fjali dhe shprehje me përshkallëzim më të lartë vështirësie drejt nivelit B1.2, në situata më të ndërlikuara drejt një shkalle më të lartë saktësie.

	Objektiva
Elemente gramatikore	<p>Në fund të klasës së 11-të nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të zgjedhojë; • të shkruajë; • të tregojë; • të komunikojë; • të analizojë, • të përdorë; • të riprodhojë në mënyrë krijuese; • të bëjë hipoteza; • të argumentojë; • të përdorë në mënyrë krijuese foljen në kohë dhe kombinime të ndryshme, formën veprorë dhe pësore të foljes, foljet kalimtare e jokalimtare, struktura më komplekse të ligjëratës së drejtë dhe të zhdrejtë, fjalitë e përbëra (kushtore, dëshimore, kohore), dallimet kuptimore në përdorimin e formave të pashtjelluara, lidhëzat, format më të ndërlikuara të foljeve frazale e modale, përemrat vetvetorë, përemrat e pacaktuar, rendin e fjalëve në fjali, mbiemrat dhe format e tyre më të ndërlikuara, ndajfoljet dhe nyjat, emrat e përbërë, parashtesat dhe prapashtesat nëpërmjet situatave të ndryshme nga jeta e përditshme.

4. OBJEKTIVAT SIPAS AFTËSIVE GJUHËSORE

Aftësia	Objektiva
Të dëgjuarit	<p>Në fund të klasës së 11-të nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të ndjekë një ligjëratë ose parashtrim mbi tema të interesit personal dhe profesional, ku tema të jetë e njohur dhe paraqitja e drejtpërdrejtë, e

Sunt

	<p>thjeshtë dhe e ndërtuar qartë;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të ndjekë thelbësoren e një ligjërimi jo shumë të ndërlikuar; • të kuptojë me pak sforcim një pjesë të madhe të asaj që është thënë në praninë e tij nga folës vendas me kusht që t'i jepet mundësia që të kërkojë nganjëherë përsëritje e riformulime. • të kuptojë idetë kryesore të një materiali të regjistruar e disi të ndërlikuar nga pikëpamja e brendisë dhe të formës mbi një temë konkrete, të karakterit profesional, e shprehur kjo me një gjuhë standarde; • të kuptojë një informacion faktik, të drejtpërdrejtë mbi tema të jetës së përditshme dhe të fushës së tij profesionale; • të kuptojë shumicën e emisioneve të lajmeve dhe revistave televizive, tema e të cilave është e interesit personal, gjuha standarde dhe e artikuluar qartë; • të kuptojë sakte lajmërimet dhe mesazhet të përditshme mbi tema konkrete e teknike;
<p>Të lexuarit</p>	<p>Në fund të klasës së 11-të nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të kuptojë me pak vështirësi tekste faktike mbi tema konkrete të përditshme si dhe të fushës së tij profesionale; • të kuptojë tekste të një vështirësie mesatare që përmbajnë një fjalor të njohur, si dhe të identifikojë fjalë e shprehje të panjohura nga konteksti; • të njohë llojet kryesore të letrave standarde të zakonshme mbi tema të njohura (kërkesë informacioni, porosi, konfirmime); • të gjejë një informacion specifik dhe të parashikueshëm në dokumentet e përditshme të thjeshta si dhe manuale teknike (si: meny, lajmërimet, orare, udhëzime të ndryshme përdorimi, garanci, etj); • të gjejë një informacion specifik në një listë dhe të veçojë informacionin e kërkuar; • të identifikojë shenjat dhe tabelat e përditshme në vendet publike të tilla, si: rrugë, restorante, stacione; • të dallojë informacionin e duhur në shumicën e shkrimeve të thjeshta, si: në letra, broshura dhe

	<p>artikuj të shkurtër të gazetave që përshkruajnë fakte;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të kuptojë artikujt e specializuar të fushës së tij, edhe duke u konsultuar herë pas here me fjalori për të verifikuar kuptimin; • të identifikojë përmbajtjen dhe të vlerësojë përshtatshmërinë e një informacioni, të një artikulli apo të një reportazhi me një gamë të gjerë temash; • të kuptojë përshkrimin e ngjarjeve, ndjenjave, dëshirave në mënyrë të mjaftueshme për të mbajtur një korrespondencë të rregullt me një mik; • të kuptojë mënyrën e përdorimit të një aparati elektronik kur ai është i drejtpërdrejtë dhe i hartuar qartë.
<p>Të folurit</p>	<p>Në fund të klasës së 11-të nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të komunikojë me siguri të kënaqshme mbi tema të njohura të zakonshme dhe që janë të lidhura me interesat e tij; • të shkëmbejë, të verifikojë e të konfirmojë informacione, të përballojë situata të veçanta dhe të shpjegojë përse ka vështirësi; • të shpjegojë me njëfarë sigurie se përse diçka përbën problem, të diskutojë mbi vazhdimin, të krahasojë e të përballë zgjidhjet; • të komentojë shkurt pikëpamjen e dikujt; • të vërë në dukje domethënien personale të fakteve dhe përvojave, të shprehë opinione mbi to; • të reagojë ndaj ndjenjave të tilla, si: habia, gëzimi, trishtimi dhe t'i shprehë ato dhe t'i përcjellë ato tek bashkëbiseduesi; • të formulojë një ankesë, të parashtrojë arsyet për të përfutur një zhëmtim (duke kërkuar të kthejë një objekt të blerë me defekt); • të bëjë përmbledhjen e informacioneve dhe argumenteve të dala nga burime të ndryshme në vija të trasha edhe pse me pak vështirësi; • të shprehë e të kërkojë mendimin personal në diskutime me shokët dhe të shprehë deri diku qartë pikëpamjen e tij në një debat. • të shprehë me mirësjellje pikëpamjen e tij dhe

	të ftojë të tjerët të shprehin pikëpamjet e tyre mbi një temë të caktuar kulturore ose profesionale;
Të shkruarit	<p>Në fund të klasës së 11-të nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të shkruajë qartë tekste të strukturuar mirë mbi një gamë temash të përgjithshme dhe profesionale, duke lidhur një seri elementesh të dallueshme në një sekuencë lineare; • të bëjë përshkrime të thjeshta, të drejtpërdrejta mbi një gamë të gjerë temash të njohura brenda fushës së tij/saj të interesit; • të shkruajë një letër personale për të dhënë të rehat dhe të shprehë mendimin e tij mbi një temë profesionale ose kulturore, si: film, muzikë etj.; • të shkruajë shënime dhe letra personale për të kërkuar ose transmetuar informacione dhe të bëjë të qarta pikat që i konsideron të rëndësishme; • të bëjë përmbledhjen e një përvoje, duke përshkruar ndjenjat dhe reagimet e tij, në një tekst të thjeshtë e koherent; • të shkruajë ese të shkurtra mbi tema të interesit të përditshëm;

5. KËRKESA TË GJUHËS ANGLEZE NDAJ LËNDËVE TË TJERA

Programi i klasës së 11-të për gjuhën angleze për shkollat e mesme profesionale mbështetet në integrimin ndërlëndor, përmes njohurive gjuhësore të trajtuara në kontekste kuptimore, parashtruar në fusha tematike që ndërthuren edhe me lëndët e tjera.

Njohuritë e përgjithshme, si dhe ato të lëndëve të tjera që ndërthuren me ato të gjuhës angleze, u paraprijnë njohurive gjuhësore të gjuhës angleze të përshkruara dhe parashtruara në këtë program.

Por, pavarësisht nga sa u përmend më lart, programi i gjuhës angleze ka integrim ndërlëndor, i cili lidhet ngushtë me njohuritë që nxënësit marrin në lëndë të ndryshme, si: në matematikë, kimi, biologji, lëndët e shkencave sociale dhe në informatikë apo lëndët e formimit profesional. Me konkretisht, lëndët me të cilat mund të ndërveprojë gjuha angleze janë:

Teknologjia, ku nxënës/i,-ja aftësohet të përdorë internetin, e-mailin, programe të ndryshme që e ndihmon atë të eksplorojë të rehat mbi botën që ai/ajo studion.

Gjeografia, njohuritë e së cilës mund të japin informacion, p.sh.: për vendet turistike në Britaninë e Madhe, SHBA, Kanada etj, duke lehtësuar kuptimin e temave mbi

Signat

turizmin, zakonet turistike, kulturën e pushimeve apo të kohës së lirë, parapëlqimet, shijet që lidhen me to etj.

Sociologjia, e cila mund të lehtësojë kuptimin e dokeve, zakoneve, vlerave shoqërore të një populli të huaj që kushtëzohen nga një kontekst shoqëror dhe një realitet i ndryshëm nga i yni. Vetë njohja e gjuhës së huaj dhe e një kulture të huaj kultivon tek nxënës/i,-ja ndjenja të tolerancës, pranimit të diversitetit etj., që lidhen ngushtë me zbatimin e të drejtave të njeriut dhe edukimin qytetar.

Historia, e cila me ngjarje dhe fakte të mëdha mund të ndihmojë në formimin kulturor e intelektual të nxënës/it,-es, njohjen e vlerave historiko-shoqërore të vendeve anglisht-folëse, personaliteteve të shquara, ngjarjeve të mëdha historike etj.

6. KËRKESA PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Programi i gjuhës angleze për klasën e 11-të të shkollave të mesme profesionale është një dokument zyrtar, pjesë e tërësisë së dokumenteve zyrtare për lëndën e gjuhës angleze, si: kurrikula e gjimnazit dhe standardet e fushës kurrikulare, ku kjo lëndë bën pjesë. Ky program reflekton hapat që përdoruesit (p.sh.: mësues/e, instruktorë/e etj.) ndërmarrin gjatë planifikimit të procesit të mësimdhënie/mësimnxënies, si dhe të vlerësimit.

Tipari kryesor i kurrikulës për shkollat e mesme profesionale është dhënia në formë spirale e kompetencave gjuhësore, që nënkupton përsëritjen dhe rimarrjen e tyre në veprimtari dhe kontekste gjuhësore gjithnjë e në rritje. Për këtë arsye, përdoruesit e programit duhet të njihen me programet lëndore të lëndës së gjuhës angleze për klasat paraardhëse, si dhe nivelin gjuhësor A1, A2, B1, sipas Kuadrit Evropian të Referencave për Gjuhët.

Zbatimi i programit duhet të bëhet duke respektuar parimet e barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore dhe fetare.

Zbatimi i programit realizohet nëpërmjet hartimit individual të planeve vjetore, semestrare dhe ditore, ku mësues/i,-ja ka liri veprimi në përputhje me nevojat e nxënësve.

Objektivat

Objektivat e parashtuar në programin e gjuhës angleze për klasën e 11-të janë të detyrueshëm për t'u realizuar, si nga mësues/i,-ja, edhe nga nxënës/i,-ja. Kjo do të thotë se të gjithë nxënësve duhet t'u jepet mundësia që të nxënë çka përshkruhet tek objektivat. Realizimi i objektivave në tema, kapituj e njësi mësimore dhe renditja e tyre është zgjedhje e lirë e zbatuesit të programit.

Meqenëse niveli i nxënësve brenda klasës është i ndryshëm, atëherë mësues/i,-ja ka nevojë të bëjë punë të diferencuar me nxënësit e tij/saj. Kjo kërkon që, përveç përcaktimit të objektivave të përgjithshëm të arritjeve, të përcaktojë edhe objektivat për nxënësit e nivelit të ulët, të nivelit mesatar dhe të nivelit të lartë.

Orët mësimore

Gjuha angleze për klasën e 11-të për shkollat e mesme profesionale zhvillohet me 2 orë mësimore në javë. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës së gjuhës angleze, mbasi sasia e orëve rekomandohet sipas fushave. Por kjo nuk do të thotë se mësimdhënia e mësimnxënia do të zhvillohet në këtë renditje gjatë gjithë vitit shkollor. Ata janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën fushë. Kjo do të thotë se, kur mësues/i, -ja ndeshet me vështirësi të caktuara në përmbushjen e objektivave të kapitullit, ai/ajo ngadalëson hapin. Por ai/ajo mund të ecë më shpejt në realizimin e objektivave, kur vë re se nxënës/it,-et provojnë me shkrim apo me gojë një përvetësim të kënaqshëm në gjuhën angleze.

Afërsisht **70%** e orëve mësimore të përgjithshme në programin e gjuhës angleze për klasën e 11-të përdoret për shtjellimin e njohurive të reja lëndore dhe **30%** e tyre përdoren për përpunimin e njohurive (gjatë vitit dhe në fund të vitit shkollor).

Shpërndarja e orëve mësimore

Gjuha angleze për klasën e 11-të për shkollat e mesme profesionale zhvillohet me 2 orë mësimore në javë:

$$34 \text{ javë} \times 2 \text{ orë} = 68 \text{ orë vjetore}$$

Gjatë shtjellimit linear të lëndës në tekst (në module e njësi mësimore) fushat ndërthuren me njëra-tjetrën. Mësues/i,-ja është i/e lirë të bëjë kombinimin e tyre brenda një moduli ose një njësie mësimore, pavarësisht renditjes dhe shpërndarjes së orëve për sa vijon:

Komunikimi dhe formimi kulturor zë 53 orë, të cilat ndahen sipas fushave:

a) 30 orë mësimore për *kulturën dhe komunikimin* (nga të cilat, 70% e tyre, që përbëjnë 21 orë, do të jenë për trajtimin e lëndës së re, ndërsa 30% e tyre, që përbëjnë 9 orë, do të shërbejnë për përpunimin e njohurive; me përpunim do të kuptojmë p.sh.: përforcimin e informacionit të marrë në tema përkatëse apo ushtrime për mendimin kritik rreth këtij informacioni).

b) 23 orë për *aktet dhe funksionet e komunikimit* (nga të cilat, 70% e tyre, që përbëjnë 18 orë mësimore, do të shërbejnë për njohuritë e reja, ndërsa 30% e tyre, d.m.th. 5 orë mësimore, do të përdoren për përpunimin e njohurive. Në këtë fushë mësues/i,-ja bën përpunim njohurish për integrimin tërësor të lëndës d.m.th. ai/ajo jep detyra komplekse ku pasqyrohen njohuritë e përfuara sipas fushave në një modul).

Formimi gjuhësor zë 15 orë, në të cilat mësues/i,-ja shtjellon në bashkëveprim me nxënësit njohuri gramatikore dhe ushtrime gjuhësore gramatikore e leksikore (nga të cilat 70% e tyre, që përbëjnë 10 orë mësimore, do të shërbejnë për trajtimin e strukturave të reja, ndërsa 30% e tyre, që përbëjnë 5 orë, do të shërbejnë për rimarrjen, përpunimin dhe përforcimin e tyre).

Realizimi i orëve të përgjithshme (68 orë në vit) është sa i detyrueshëm, aq edhe elastik. Është i detyrueshëm sepse duhen zhvilluar të gjitha orët e planifikuara deri në fund të vitit shkollor, është elastik sepse shpërndarja përgjatë vitit dhe mbushja me material mësimor është kompetencë e mësues/it,-es të gjuhës angleze. P.sh.: 10% e orëve

Signat

sipas fushave tematike, mësues/i,-ja është i/e lirë t'i përdorë si brenda një fushe për shtesë, ashtu edhe t'i transferojë te një fushë tjetër në varësi të nevojave të nxënësve.

Sugjerohet që përmbajtja mësimore e lëndës së gjuhës angleze për klasën e 11-të për shkollat e mesme profesionale të realizohet përmes fushave tematike, jo detyruese, të cilat gjejnë pasqyrim në tema si më poshtë: Shokët, Personaliteti, Komuniteti, Udhëtimet, Figurat historike, Shkrimtarët, Artistët, Trupi dhe shëndeti, Sportet, Ushqimet dhe ushqyerja, Gjeografia e gjuhës, Mënyra e jetesës, Profesionet, Blerjet e ndryshme, Shpikësit dhe shpikjet, Teknologjia.

Përpunimi i njohurive

Përpunimi i njohurive përmban:

- përsëritjen brenda një moduli (konceptet themelore);
- testimin e njohurive bazë;
- integrimin e njohurive të reja të një moduli me njohuritë e moduleve pararendëse;
- integrimin e njohurive të reja me njohuritë e lëndëve të tjera (edhe pse ky integrim do të përshkojë zhvillimin e çdo ore mësimi, gjatë përpunimit i duhet kushtuar kohë e veçantë);
- përsëritjen vjetore (pavarësisht nga ndarja në fusha tematike ose në module, lënda duhet parë si një e tërë);
- testimin vjetor (nuk është i detyruar).

Në orët mësimore që i përkasin përpunimit të njohurive dhe aftësive, mësues/i,-ja zhvillon edhe tema me nismën e tij/saj ose me kërkesën e vetë nxënësve. Këto tema mund të pikënisen nga ngjarje aktuale ose thjesht nga kureshtja e nxënësve.

Gjatë përpunimit të njohurive duhet t'i kushtohet vëmendje dhe kohë e posaçme kultivimit të:

- aftësive të përgjithshme, si p.sh.: të komunikimit, të zgjedhjes së informacionit, të të menduarit kritik dhe krijues;
- aftësive të posaçme lëndore, si p.sh.: të dëgjuarit, të lexuarit, të folurit, të shkruarit;
- formimit të qëndrimeve, si p.sh.: qëndrimi etiko-social, si dhe qëndrimi gjatë punës në grupe të vogla.

Gjatë përpunimit të njohurive, nxënësve duhet t'u jepet mundësia të punojnë detyra tematike nga jeta e përditshme, projekte kurrikulare etj.

Rishqyrtimi vjetor, i cili bën pjesë në përpunimin e lëndës, synon të nxjerrë në pah dhe të përforcojë konceptet dhe metodat e kësaj lënde.

Programi për shkollat e mesme profesionale i klasës së 11-të orienton gjithë procesin e mësimdhënies e të mësimnxënies së gjuhës angleze në nivelin **B.1.2**

Mësues/i,-ja është i/e lirë të përdorë një larmi metodash e strategjish të mësimdhënies/mësimnxënies për t'ua përshtatur nevojave të nxënësve në klasa të ndryshme. Ai /ajo i kombinon këto metoda gjatë procesit mësimor dhe i përshtat ato në bazë të zhvillimit në rritje të kompetencave gjuhësore dhe të zhvillimit të pavarësisë së nxënës/it,-es në vijueshmëri të këtij procesi.

Mësimdhënia ka në qendër të saj metodën komunikuese, metoda me bazë detyrën, metoda funksionale dhe ajo e situatave sa më afër jetës reale etj. Zhvillimi dhe

Signat

përvetësimi i këtyre metodave gjatë mësimdhënies/mësimnxënies i aftëson nxënësit të shprehen me shkrim dhe me gojë ndërmjet njëri-tjetrit dhe shokëve e shoqeve të tyre në vendet anglishtfolëse.

Në këtë nivel gjuhësor zbatohen të gjitha strategjitë për katër aftësitë gjuhësore, por ato përshkallëzohen nga niveli në nivel në varësi të objektivave.

Këto metoda realizohen nëpërmjet strategjive dhe teknikave të ndryshme sipas aftësive gjuhësore të: të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit, të shkruarit.

Të dëgjuarit

Për të zhvilluar aftësinë e të dëgjuarit, nxënës/i,-ja ushtrohet të ndjekë këto strategji:

- të mbajë shënime gjatë dëgjimit;
- të klasifikojë çështjet që dëgjon;
- të përqendrohet e të zbulojë detaje të thjeshta;
- të hamendësojë çfarë flitet në magnetofon;
- të bëjë lidhje mes asaj që dëgjon dhe materialit vizual;
- të dëgjojë një tregim, këngë etj. disa herë, për të kuptuar idenë kryesore duke u përqendruar në fjalët që njeh;
- të përqendrohet tek kërkesa e të dëgjuarit;
- të vërë qëllime dhe objektiva për zhvillimin e aftësisë së të dëgjuarit.

Të folurit

Për të zhvilluar aftësinë e të folurit, nxënës/i,-ja ushtrohet të ndjekë këto strategji:

- t'i kërkojë folësit të përsërisë çfarë tha, në rast moskuptimi;
- të kërkojë ndihmën e bashkëfolësit kur nuk di kuptimin e ndonjë fjale apo shprehjeje;
- të përsërisë një pjesë të asaj çka thotë bashkëfolësi, për t'u siguruar për kuptimin e mesazhit që përcillet;
- të pyesë bashkëbiseduesin për të bërë të qartë atë që është thënë;
- të bëjë bisedë të ndërsjellë me bashkëbiseduesin.

Të lexuarit

Për të zhvilluar aftësinë e të lexuarit, nxënës/i,-ja ushtrohet të ndjekë këto strategji:

- të kërkojë të dhëna që e ndihmojnë për të parashikuar përmbajtjen e tekstit, si: figura, titulli i mësimet etj.;
- të lexojë tekstin për herë të dytë që të hamendësojë kuptimin e fjalëve të panjohura;
- të lexojë pyetjet rreth tekstit dhe të mendojë për përgjigjet e mundshme;
- të gjejë përgjigjet e pyetjeve në tekst, duke iu rikthyer disa herë leximit;
- të lexojë tekstin për të nxjerrë kuptimin kryesor.

Të shkruarit

Për të zhvilluar aftësinë e të shkruarit, nxënës/i,-ja ushtrohet të ndjekë këto strategji:

- të mbajë shënime për informacionin që i duhet të përfshijë në detyrën e caktuar;
- të planifikojë paragrafët duke shkruar idenë kryesore të secilit paragraf;
- të plotësojë paragrafët me informacion mbështetës si: shembuj, sqarime etj.;
- të kontrollojë lidhjen logjike të paragrafëve, duke përdorur lidhëzat përkatëse;
- të këmbëjë punën e tij/saj me atë të shokut/shoqes.

Parimet ku mbështetet zbatimi i programit

Vendosja e nxënësit në qendër të vëmendjes

Programi i gjuhës angleze për klasën e 11-të ndërtohet duke marrë parasysh njohuritë e nxënës/it,-es, aftësitë e grupmohës, interesat, talentin dhe përvojat vetjake. Kjo realizohet:

së pari, përmes temave që u përshtaten interesave dhe nevojave të tij/saj gjuhësore dhe shoqërore;

së dyti, përmes vendosjes së objektivave të përshkallëzuar që kalojnë nga niveli B.1+ drejt nivelit B.1.2

së treti, përmes strategjive që nxisin ndërveprimin gjuhësor dhe komunikativ, duke e përfshirë nxënës/in,-en edhe në organizimin e veprimtarive dhe në përdorimin e teknikave që i përshtaten atij/asaj.

Krijimi i mjedisit të të nxënës

Edhe në këtë fazë të mësimin të gjuhës, krijimi i një mjedisi shkollor fizik, emocional, sfidues dhe nxitës është i rëndësishëm për ecurinë e procesit mësimor.

Atëherë kur nxënës/i,-ja ndihet i/e sigurt, mësimdhënia dhe nxënia plotëson ndjeshëm nevojat e tij/saj dhe arrin objektivat e përcaktuar.

Organizimi i klasës

Ky element didaktik lidhet me aspekte të tilla, si: planifikimin i orës së mësimin, organizimi i etapave të mësimdhënies/ mësimnxënies, organizimi i veprimtarive, përzgjedhja e materialeve autentike, përdorimi i mjeteve audiovizuale.

Mësues/i,-ja nxit iniciativën e nxënës/it,-es për të eksperimentuar e vepruar me gjuhën me qëllim që të plotësojë nevojat e tij/saj. Për këtë përdor format e punës në grup apo në çift, duke i përfshirë nxënësit në situata komunikuese të ngjashme me ato reale, për të forcuar bashkëpunimin gjuhësor dhe për të nxitur lirshmërinë e të shprehurit.

Mësues/i,-ja i gërsheton këto herë pas here dhe në forma të punës së pavarur, ku nxënës/i,-ja krijon ose zgjidh vetë një situatë problemore.

Të mësuarit bashkëveprues/bashkëpunues

Përmes formave komunikuese të punës në grup apo në çift, gjatë organizimit të veprimtarive në klasë, mësues/i,-ja siguron ndërveprimin gjuhësor si përcaktues në

Signat

perfeksionimin e aftësive gjuhësore. Ai/ajo kujdeset të përfshijë gjithë nivelet e nxënësve në grupe dhe t'u ndajë detyrat duke u siguruar të gjithëve mbështetje dhe respekt për kontributin e dhënë në produktin e përbashkët. Këto forma rrisin shkallën e zotërimit të gjuhës dhe njëkohësisht i bën nxënësit shoqërisht më bashkëveprues, më të përgjegjshëm dhe tolerantë ndaj mendimit të tjerëve.

Përdorimi i gjuhës në klasë

Në këtë nivel nxënës/i,-ja ka vështirësi në përdorimin e gjuhës angleze, për të shprehur njohuritë e konsoliduara në gjuhën amtare, megjithatë mësues/i,-ja e nxit dhe e mbështet maksimalisht në përdorimin e saj. Disa herë mësues/i,-ja thërret në ndihmë dhe gjuhën amtare për të shmangur keqkuptimet në situata të caktuara. Gjuha angleze mbetet mbizotëruese gjatë procesit mësimor.

Të mësuarit e gramatikës

Në nivelin B.1.2 njohuritë gramatikore përshkallëzohen në sasi dhe vështirësi, por nxënësit mësojnë gramatikën në shërbim të komunikimit, larg mësimin tradicional të rregullave gramatikore. Nxënësit ekspozohen ndaj njohurive të reja gramatikore, gjatë trajtimit të përmbajtjes së materialit të ofruar përmes tematikës apo funksioneve gjuhësore e komunikuese. Përdorimi dhe ngulitja e mëtejshme e njohurive gramatikore sigurohet nëpërmjet veprimtarive dhe praktikave komunikuese.

Qortimi i gabimeve

Qortimi i gabimeve bëhet me shumë kujdes, në mënyre që të mos shkurajohen nxënësit gjatë të shprehurit në gjuhën angleze, sidomos në këtë nivel gjuhësor ku nxënësit akoma s'kanë fituar sigurinë e duhur për të vepruar lirshëm me gjuhën..

Qortimi i kujdesshëm nxit iniciativën, motivon nxënës/in,-en të eksperimentojë me njohuritë që ka dhe e bën atë më vetëbesues. Rrjedhshmëria gjuhësore është shumë e rëndësishme në këtë fazë, prandaj mësues/i,-ja ndërhyt me takt. Ai/ajo përdor forma të larmishme, qorton më shpesh kur nxënës/it,-et praktikojnë strukturat gramatikore dhe më rrallë kur ata janë duke punuar në grup, duke debatuar, apo duke diskutuar për tema të ndryshme.

Puna e diferencuar me nxënësit.

Më qëllim që të arrihen objektivat sipas standardeve të përcaktuara për nivelin B.1.2, mësues/i,-ja planifikon punën e diferencuar me nxënësit.

Meqë niveli i arritjeve të nxënësve që i nënshtrohen programit të gjuhës angleze të klasës së 11-të për shkollat e mesme profesionale nuk është i njëjtë për të gjithë nxënësit, është e domosdoshme që veprimtaria mësimore të bazohet në parimet e pedagogjisë së diferencuar, ku çdo nxënës/e të ndihet aktiv/e, duke vënë në funksion njohuritë gjuhësore që ai/ajo ka, si dhe mundësitë në shërbim të të nxënësit të tij/saj të mëtejshëm. Prandaj, mësues/i,-ja planifikon një sërë metodash mësimdhënieje, teknika, strategji, forma vlerësimi që u përshtaten jo vetëm veçorive moshore të adoleshencës, por edhe temperamenteve individuale. Gjithashtu, mësues/i,-ja identifikon aftësinë

përthithëse dhe mënyrat e veçanta të të nxënësve, duke përzgjedhur ato më efektive për gjithsecilin.

Me qëllim që t'i tërheqë të gjithë nxënësit në mësim, mësues/i,-ja duhet të përdorë disa *teknika*, si:

- të dëgjojë me kujdes nxënësit kur flasin dhe t'u japë përgjigje nxënësve në kohën e duhur;
- të ndjekë ecurinë e çdo individi duke mbajtur shënime përkatëse;
- të ndajë përgjegjësitë e nxënësve për veprimtaritë individuale apo në grup;
- të japë vazhdimisht përshkrime të punës së nxënësve;
- të kërkojë prej tyre vlerësime të punës së tij/saj, me qëllim që të reflektojë ndaj dobësive;
- të motivojë nxënësit në mënyrë të barabartë;
- të nxisë pjesëmarrjen e nxënësve indiferentë në punën në grup dhe të nxjerrë në pah punën e tyre.

7. VLERËSIMI

Zbatimi i udhëzimeve për përdorimin e programit të klasës së 11-të bën të mundur vënien në praktikë të një mënyre vlerësimi bashkëkohore të dijeve të nxënës/it,-es d.m.th. me bazë vlerësimin komunikativ me shkrim dhe me gojë gjatë gjithë procesit mësimor. Kjo metodë vlerësimi mbështetur në Kuadrin e Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët dhe në Portofolin Evropian për Gjuhët, jo vetëm përshkon gjithë procesin mësimor, por shërben edhe për përmirësimin e këtij procesi.

Vlerësimi i nxënës/it,-es bëhet me notë sipas sistemit të vlerësimit të vendosur nga MASH-i dhe AVA. Ky vlerësim nuk përfundon me vendosjen e notës. Ai përqendrohet tërësisht në monitorimin dhe vlerësimin e njohurive të nxënësve të përfuara në vazhdimësi, si dhe të rezultateve të arritura gjatë procesit të mësimdhënies/mësimnxënies.

Kur vlerësimi mbështetet në aktivitetet e organizuara në klasë, të parashikuara në program në përputhje me objektivat e tij, ai siguron:

- një matje të rregullt të ecurisë së nxënës/it,-es në gjuhën angleze;
- një informacion për rivlerësim të përmbajtjes lëndore, si dhe cakton detyrat për të ardhmen;
- një përmirësim të njohurive të nxënës/it,-es;
- një përgjegjshmëri të gjithë pjesëmarrësve në procesin e mësimdhënies/mësimnxënies (nxënës/e, mësues/e të gjuhës angleze dhe ndërlëndor, drejtorja e shkollës, inspektori i arsimit për gjuhën angleze dhe detyrimisht edhe prindërit).

Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat e programit lëndor dhe mësues/i,-ja nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënës/in,-en për ata objektiva të arritjes që nuk përshkruhen në program.

Objektiv i vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë dhe aftësitë, por edhe qëndrimet e nxënësve, si qëndrimet etiko-sociale, në përgjithësi dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët, në veçanti. Vlerësimi i nxënës/it,-es duhet të jetë sa më objektiv dhe i matshëm. Asgjë

nuk është më nxitës, sesa sukcesi i arritur duke u përballur me gjendjen reale në të cilën ndodhet një nxënës/e.

Mësues/i,-ja monitoron dhe vlerëson detyrat, duke përcaktuar objektiva të qartë.

Mësues/i,-ja përdor vetë dhe ndihmon edhe nxënësit që të përdorin një larmi mënyrash vlerësimi.

Vlerësimi mund të organizohet në disa forma:

Vlerësimi i dijeve (ose i niveleve), ku përfshihet vlerësimi i objektivave specifike. Ky vlerësim ka lidhje me atë çka është mësuar gjatë një jave, muaji ose semestri, pra me punën që është bërë me tekstin dhe programin. Vlerësimi i dijes është i bazuar në orën e mësimit. Kështu ai i përgjigjet një vështrimi të brendshëm. Ky lloj vlerësimi është pozitiv për faktin se është më afër përvojës së nxënës/it,-es

Vlerësimi i kapaciteteve (i zbatimit të aftësive ose i performancës), që është vlerësimi i asaj çka nxënësit mund të bëjnë ose dinë në raport me zbatimin e saj në jetën e përditshme dhe i lejon secilit të pozicionohet aty ku e meriton, pasi rezultatet janë më se të dukshme.

Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj. Nxënës/i,-ja vlerësohet me notë, ndërsa demonstroi arritjet e tij/saj me gojë, me shkrim ose nëpërmjet veprimtarish e produktesh të tjera, si: vallëzon, eksperimenton, prodhon një maket etj.

Vlerësimi me shkrim dhe me gojë klasifikohet në:

Vlerësim formues, me anë të të cilit merret informacion rreth asaj që është arritur nga nxënës/i,-ja në formimin e tij/saj gjuhësor, në përputhje me objektivat e caktuara.

Vlerësim diagnostikues, i cili bëhet në mënyrë të vazhdueshme, për të marrë informacion rreth përgatitjes ditore dhe përvetësimit të materialit gjuhësor të dhënë më parë. Ai, gjithashtu, jep informacion për efektivitetin e të nxënësit dhe ndihmon në ecurinë e mëtejshme të mësimdhënies/nxënies.

Vlerësim motivues, ndihmon për të nxitur dëshirën e nxënës/it,-es për mësimin e gjuhës angleze. Ky vlerësim është i vazhdueshëm dhe gjatë gjithë procesit mësimor. Mësuesi realizon këtë lloj vlerësimi duke gjetur shprehjet e duhura motivuese, si p.sh.: mirë, shumë mirë etj. dhe duke përdorur materiale që nxënësit vlerësimin motivues të nxënësit, p.sh.: përgatitja e dosjes së arritjeve të nxënësit si pjesë e Portofolit Evropian të Gjuhëve, ku ai vendos certifikata, provime, projekte, dëshmi etj. që provojnë ecuri të tij/saj në gjuhë.

Në punime të nxënësve me grupe të vogla, mësues/i,-ja parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit në tërësi dhe të çdo nxënës/ i,-eje, në veçanti.

Mësues/i,-ja nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve dhe vendosjen e notave në regjistër për çdo orë mësimore. Si rregull, nxënësit dhe mësuesit duhet të bashkëbisedojnë lirshëm, si partnerë, rreth përvetësimit të njohurive të fituara nga orët e kaluara dhe kryerjes së detyrave jashtë klase.

Herë pas here, mësues/i,-ja duhet të vlerësojë me notë, duke ua bërë të qartë nxënësve që në fillim qëllimin e vlerësimit dhe kriteret e tij.

Vlerësimi me shkrim shërben për aftësimin në komunikimin me shkrim dhe mund të realizohet jo vetëm me laps e letër, por edhe në rrugë elektronike.

Mësues/i,-ja vlerëson nxënës/in,-en me notë për parashtrimet me shkrim në provimet periodike me shkrim dhe në prezantimet me shkrim të punimeve të tij/saj, të realizuara vetë ose në grup.

Sunt

Vetëvlerësimi

Vetëvlerësimi është një tjetër element i rëndësishëm i vlerësimit në mësimin e gjuhës angleze, ku secili jep gjykimin për zotësinë e vet. Vetëvlerësimi është një plotësues i domosdoshëm i vlerësimit nga mësues/i,-ja dhe nga provimet, madje dhe nga prindërit e institucione të tjera vlerësuese. Vetëvlerësimi ka efekt kur ai u referohet normave dhe kapacitetit që korniza e gjuhëve parashtron për grupmoshën e nxënësve dhe kur ky vlerësim është i lidhur me një përvojë të veçantë, që mund të jetë ajo e kalimit të testeve. Vënia e synimeve të qarta në program, mundëson vetëvlerësimin e tyre në vazhdimësi.

PEGJ-i është dokumenti që çdo nxënës/e që mëson një gjuhë ose ka mësuar një gjuhë, në shkollë ose jashtë saj, mund të shënojë njohuritë e tij gjuhësore dhe eksperiencat kulturore. PEGJ-i nxit çdo nxënës/e të mësojë më shumë gjuhë, edhe në nivele modeste dhe të vazhdojë t'i mësojë gjatë gjithë jetës. PEGJ-i nxit nxënës/in,-en të përmirësojë mësimin dhe kapacitetin e vlerësimit të aftësive të tij/saj në fushën e gjuhëve.

Përdorimi i PEGJ-it favorizon lëvizjen në Evropë duke informuar për aftësitë për gjuhët në mënyrë të qartë dhe të krahasueshme në nivel ndërkombëtar. PEGJ-i kontribuon në mirëkuptimin reciprok në Evropë nëpërmjet eksperiencës së kulturave të tjera dhe me ndihmën e kapaciteteve të komunikimit në shumë gjuhë.

Nxënësit vlerësojnë punën e tyre në çifte. Më pas mësues/i,-ja dhe nxënësit bëjnë komentin përfundimtar.

Nxënësit, gjithashtu, vlerësojnë punën e njëri-tjetrit në grupe, duke marrë role të ndryshme, madje dhe pa nevojën e ndihmës së mësues/it,-e.

Nxënës/i,-ja mban shënim arritjet e tij/saj, duke përdorur edhe gjuhën amtare.

Mësues/i,-ja bisedon me nxënësin individualisht dhe i tregon arritjet.

Interesi më i madh i vetëvlerësimit qëndron në faktin se ai është faktor motivimi dhe ndërgjegjësimi: ai i ndihmon nxënësit të njohin pikat e tyre të forta dhe të dobëta dhe kështu, të organizojnë më mirë të nxënësve të tyre. Nga vetëvlerësimi përfiton si nxënës/i,-ja, ashtu edhe mësuesi.